



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR ME: PRIMLJENQ DANA:		10.03.2026	
NJESIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDE BR. PAGESHET	SHTOJCA PRILUG
05-	453/01-	11966	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 10.03.2026

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtori i DKRS-së shpallë :

Thirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e aktiviteteve të OJQ-ve të regjistruara.

1. **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për aktivitete të organizimit “ **Rinia Fest-Lipjan 2026** ” në Komunën e Lipjanit.

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt në lëmin e rinisë dhe kulturës përmes objektivave e aktiviteteve rinore dhe kulturore, që janë të shumëllojshme.

Objektivat janë:

1. Konferencë rinore
2. Kamp veror
3. Event përmbyllës me pjesëmarrësit

2. Përfituesi do të kujdeset për: Ofrimin e aktiviteteve me të cilin do të përmbushen të gjitha objektivat e thirrjes publike (detajet tjera rreth kësaj thirrje do të i gjeni në udhëzuesin i cili do të publikohen në web faqe, së bashku me formularët e aplikimit)
4. Vlera totale e mbështetjes sipas thirrjes është **3,000.00 euro** (katër mijë euro). Minimale **501.00€** deri në **3,000.00€**.
5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **31.03.2026**.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, dhe të cilat veprojnë në **territorin e komunës së Lipjanit**. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe rekreacion. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur

rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

6. Drejtorët e OJQ-ve aplikuese nuk mund të jenë në lidhje të ngushtë familjare me drejtorët, përkatësisht aplikantët e OJQ-ve tjera aplikuese.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:
Komuna e Lipjanit, Rruga „Shqipëria” Zyra për shërbim të qytetarëve, nr 3,

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

9. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: **pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net**

Burim Rrustemi
Drejtore për Kulturë, Rini dhe Sport

